

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
iNext sh.p.k.

Ne kete Statut:

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", (*i perditeluar*).
- "Ligji per QKB" eshte Ligji Nr. 131/2015, date 26.11.2015, "Per Qendren Kombetare te Biznesit".
- "Ligji per Regjistrimin e Biznesit" eshte Ligji Nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Regjistrimin e Biznesit", (*i perditeluar*).
- "Statut" eshte Statuti i Shoqerise Tregtare "iNext" sh.p.k.

KREU I
EMERTIMI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni 1
Emertimi, Forma dhe Ortaket

- 1.1 Sot, me date 25.06.2025, ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar ne fuqi, ne Ortaket e Shoqerise, kemi miratuar kete Statut te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **iNext sh.p.k.**, me emertimin tregtar **iNext**, e cila organizohet dhe funksionon si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar. Shnderrimi i saj ne nje forme tjeter do te realizohet ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", (*i perditeluar*).
- 1.2 Shoqeria zoterohet nga Ortaket:
 - **TAG Engineering shpk**, shoqeri e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) me date 07.12.2017, identifikuar me Numer Unik te Identifikimit te Subjektit (NUIS) L72407008S, me Adrese Rr. Murat Toptani, godina Gjergji Center, Tirane, perfaqesuar nga Znj. Edlira Shara, ne cilesine e Administratorit te Pergjithshem.
 - **Z. Bledar Dhima, shtetas shqiptar**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

Neni 2
Objekti

- 2.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar iNext sh.p.k do te zhvilloje aktivitetet si me poshte:
 - a) Disenjim software-i. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet analiza e kërkesave të sistemeve software, projektimi i arkitekturës dhe disenjimi i detajuar i këtyre sistemeve;
 - b) Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve software. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet në programim e sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentacioni, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas vënies në

- punë të software-it), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, mbështetja e sistemit si një grup komponentësh që, në funksionimin e tyre, përmbushin qëllimin e zgjidhjes së teknologjisë së informacionit;
- c) Testimi i software-it. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet në testimin e funksionalitetit, ngarkesës së punës, performancës, problemeve të kodit, disponueshmërisë dhe sigurisë së sistemit software;
 - d) Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të komunikimit. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vënia në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjetit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit (LAN/WAN/WLAN/MAN/SAN/CAN);
 - e) Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të sigurisë. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet, analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimi dhe konfigurimi i komponentëve, zbatimi, testimi dhe mirëmbajtja e sigurisë së sistemeve dhe produkteve;
 - f) Zhvillimi i sistemeve të migracionit. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet, transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një të re dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit;
 - g) Analiza e sistemeve me sasi të madhe të dhënash. Analiza e sistemeve të përpunimit dhe analiza e sasive të mëdha të të dhënave, të quajtura si Big Data. Mbi bazën e këtyre të dhënave mund të ndërtohen modele, të cilat, më pas, me përdorimin e inteligjencës artificiale mund të shfrytëzohen për aktivitete biznesesh të ndryshme;
 - h) Konsulencë për inovacion. Konsulencë për përdorimin e teknologjisë së informacionit për qëllime të inovacionit (riinxhinierimit) të proceseve të biznesit me zhvillimin e kërkesave teknike për sistemet e informacionit dhe software;
 - i) Konsulencë për sigurinë e informacionit. Konsulencë për mbrojtjen teknike dhe kriptografike të informacionit, duke përfshirë përdorimin e nënshkrimit elektronik digjital;
 - j) Konsulencë në auditime, operacione, menaxhim, mbështetje e përdoruesve, trajnime dhe konsulencë për auditime të teknologjisë së informacionit për sistemet software;
 - k) Kërkime në fushën e komunikimit. Kërkim dhe zhvillim në fushën e shkencave natyrore dhe teknike që përfshijnë teknologjitë e informacionit e të komunikimit;
 - l) Kërkime në fushën e zhvillimit të programeve inovative. Kërkimi dhe zhvillimi nënkupton aktivitete krijuese dhe sistematike të ndërmarra për të rritur grupin e njohurive dhe për të krijuar aplikime të reja të njohurive të disponueshme. Termi kërkim dhe zhvillim përfshin tri lloje të kërkimit:
 - kërkimin bazë;
 - kërkimin e aplikuar;
 - zhvillimin eksperimental.
 - m) Kërkimi dhe zhvillimi në fushën e robotikës. Projektimi (inxhinierimi), kërkimi, testimi i aktiviteteve që përfshijnë teknologjitë robotike, pajisjet dhe sistemet që përdorin sisteme të kompjuterizuara kontrolli.
 - n) Aktivitete në fushën Cloud Computing. Kërkime në Cloud Computing dhe vlerësimin e rrezikut të
 - o) migrimit të shërbimeve on-premises drejt shërbimeve Cloud;
- 2.2 Shoqeria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër në fushën e teknologjisë së informacionit, të përcaktuara nga ligji nr. 58/2022, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e



parqeve teknologjike dhe shkencore" si dhe cdo akt ne zbatim te tij, si dhe cdo aktivitet mbeshketes ne funksion te aktiviteve te percaktuara ne piken 2.1.

Neni 3 Kohezgjatja

3.1 Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise iNext sh.p.k. eshte e pakufizuar.

Neni 4 Selia

- 4.1 Selia e Shoqerise iNext sh.p.k. eshte ne adresen: Durana Tech Park, Rruga Ahmet Zogu, nr. pasurisë 336, ZK 3852, njësia administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, kodi postar 2013.
- 4.2 Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj. Per kete arsye, ajo mund te hape dhe dege te tjera, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.
- 4.3 Selite dytesore te Shoqerise ne Shqiperi hapen me vendim te Administratorit te Shoqerise.

KREU II KAPITALI

Neni 5 Shuma dhe Pagesat e Kapitalit te Regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i Shoqerise "iNext" sh.p.k., eshte 100,000 (njqind mije) Leke, i ndare ne 2 (dy) kuota, nga nje kuote per secilin ortak.
- 5.2 Vlera e kuotes per secilin Ortak eshte e barabarte me vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te Shoqerise, e cila do te quhet "vlerë nominale"
- 5.3 Pjesemarrja e Ortakeve ne kapitalin e Shoqerise iNext sh.p.k. eshte si me poshte:
- TAG Engineering shpk, zoteron nje kuote e cila perben 66.663% te kapitalit te regjistruar te shoqerise
 - Z. Bledar Dhima zoteron nje kuote te kapitalit themeltar te shoqerise, e cila perben 33,337% te kapitalit te regjistruar
- 5.4 Kapitali i regjistruar i Shoqerise mund te perbehet nga kontribute ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta) nga fitimi dhe nga cdo lloj tjeter kontributi i percaktuar ne ligj.

Neni 6 Transferimi i Kapitalit

- 6.1 Kuotat e kapitalit te Shoqerise dhe te drejtat e detyrimet qe rrjedhin prej tyre, mund te fitohen, apo kalohen nepermjet:
- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
 - b) shitblerjes;



- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

6.2 Transferimi i kuotes/ave te kapitalit tek palet e treta, pjeserisht apo teresisht, me perjashtim te nenit 6.4, mund te behet vetem me ane te nje kontrate shitjeje me shkrim dhe pasi te jene plotesuar kushtet ne nenin 6.3.

6.3 Nese njeri nga Ortaket ("Ortaku Shites") ka per qellim te transferoje kuoten e tij ne Shoqeri teresisht ose pjeserisht, ateherë ky ortak do t'i beje me dije me shkrim qellimin per te shitur Ortakeve te tjere ("Ortaket Jo-Shites") dhe Administratorin/et e Shoqerise nepermjet ("Njoftim per Qellim Shitje"), se bashku me cmimin e propozuar te shitjes dhe kushtet e pageses se cmimit. Njoftimi apo cdo komunikim i nevojshem sipas ketij neni, ndermjet Ortakeve, duhet te jete me shkrim, ne gjuhen shqipe, dhe duhet te dergohet dhe/ose merret ne nje prej menyrave te meposhtme:

- Dergim dorazi; ose
- Me e-mail; dhe
- Me poste rekomande

Secili Ortak ka te drejte te bleje kuoten ne shitje me kushtet dhe cmimin e propozuar nga Ortaku Shites duke njoftuar qellimin e tij mbi blerjen brenda 30 diteve pune nga dita qe kane marre dijeni per ("Njoftimin per Qellim Shitje"), tek Ortaku Shites dhe Administratori i Shoqerise, me kusht qe shitja te realizohet perfundimisht brenda 30 diteve pune te tjera nga mbarimi i afatit te pare per ("Njoftimin e Qellimit te Blerjes"). Ne rast se me shume se nje Ortak Jo-Shites njofton qellimin e tij per blerjen e kuotes se Ortakut Shites, secili prej tyre ka te drejte te bleje nje perqindje te kuotes ne shitjes ne raport te drejte me pjesen e tij ne kapitalin e Shoqerise.

Nese pas ezaurimit te procedures se mesiperme, Ortakut Shites merr nje oferte nga nje pale e trete jashte Ortakeve te Shoqerise, per blerjen e kuotes me cmimin dhe kushtet e ofruara nga Ortaku Shites sipas paragrafit te pare te Nenit 6.3, Ortaku Shites ka te drejte te realizoje shitjen me kete pale te trete pa asnje kufizim.

Nese Ortaku Shites, pas realizimit te procedures se parashikuar ne paragrafin e pare te Nenit 6.3, do te transferoje kuoten e tij ne Shoqeri teresisht ose pjeserisht tek nje pale e trete nga e cila ka marre nje oferte per blerjen e kuotes me nje cmim me te ulet se cmimi i propozuar nga Ortaku Shites sipas paragrafit te pare te nenit 6.3, ateherë ky Ortak do te njoftoje menjehere Ortaket Jo-Shites dhe Administratorin/et e Shoqerise, per te gjithë kushtet dhe afatet e transferimit te ardhshem te kuotave ("Njoftimi per Shitje"), duke perfshire por pa u kufizuar ne: (i) emrin e perfituesit te transferimit, (ii) cmimin qe do te paguhet per kuotat, duke percaktuar nese cmimi do te paguhet ne para apo ne natyre; (iii) menyren dhe kushtet e pageses se cmimit; (iv) nje konfirmim me shkrim nga bleresi se oferta ndaj Ortakut Shites eshte bere ne mirebesim (v) garanci bankare per cmimin e blerjes. Ortaket Jo-Shites mund te ushtrojne te drejten e parablerjes mbi kuoten ne shitje me ane te njoftimi me shkrim, derguar tek Ortaku Shites dhe Administratori i Shoqerise brenda 30 tridhjete diteve pune nga dita qe kane marre njoftimin per shitje ("Njoftimi per Blerje").



Njoftimi per Blerje duhet ne menyre te shprehur te permende vullnetin e Ortakeve Jo-Shites per te ushtruar te drejten e parablerjes mbi kuoten e treguar ne Njoftimin per Shitje me te njejtin çmim, kushte dhe afate siç parashikohet ne Njoftimin per Shitje. Ne rast se me shume se nje ortak JoShites ushtron te drejten e parablerjes, secili prej tyre ka te drejte te bleje nje perqindje te kuotave proporcionalisht me kuotat e zoteruara nga Ortaket Jo-Shites te cilet kane ushtruar te drejten e parablerjes ne menyren e duhur sipas parashikimeve te mesiperme.

Ne rast se e drejta e parablerjes nuk eshte ushtruar dhe realizuar brenda afatit te mesiperm, Ortaku Shites mund te transferoje kuotat e tij tek pala e trete por vetem nese transferimi eshte kryer sipas te njejtave kushte dhe afate te parashikuara ne Njoftimin per Shitje.

6.4 Perjashtohen nga kufizimi i parablerjes, sipas nenit 6.3 rastet e meposhtme:

1. Kur Ortaku individ ia transferon/shet kuotat e tij (qofte edhe nepermjet dhurimit):
 - a. familjareve te vet, ku perfshihen femijet, femijet e femijeve, bashkeshorti, prinderit, vellezerit e motrat.
 - b. çdo subjekti juridik, i cili zoterohet nga vete ortaku individ dhe/ose familjaret e vet, te percaktuar sipas perkufizimit te pikes 6.4.1.a.
2. Kur Ortaku qe eshte subjekt juridik ia transferon/shet kuotat e tij (qofte edhe nepermjet dhurimit) ortakut/eve te Shoqerise (qofshin keta individe apo subjekte juridike) pavaresisht ndarjes midis tyre te kuotes/ave qe do transferohen.
3. Kur Ortaku qe eshte subjekt juridik ia transferon/shet kuotat e tij (qofte edhe nepermjet dhurimit) çdo subjekti juridik i cili zoterohet teresisht ose pjesisht direkt apo indirekt nga ortaku individ i cili zoteron teresisht apo pjesisht Ortakun shites/transferues te Shoqerise, dhe/ose familjaret e tij te percaktuar sipas perkufizimit te pikes 6.4.1.a.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit

- 7.1 Kapitali i regjistruar i Shoqerise mund te zmadhohet duke nenshkruar kuota te reja ose duke rritur vleren nominale te kuotes ekzistues me kontribute ne para, ne natyre, nga fitimi dhe nga çdo lloj tjeter kontributi i percaktuar ne ligj.
- 7.2 Ortaket kane te drejte te nenshkruajne rritjen, ne perputhje me raportin e vleres nominale te kuotes se secilit Ortak me kapitalin e Shoqerise.
- 7.3 Menyra e rritjes se kapitalit (nenshkrimi i kuotes/ave te reja apo zmadhimi i vleres nominale te kuotes/ave) dhe metodat dhe afatet e pagimit te kontributeve nga ortaket do te vendoset rast pas rasti me vendim te Asamblese se Ortakeve. Vendimet e Asamblese se Ortakeve mund te perfshijne nder te tjera denimet dhe pasojat per nje ortak ne rast te mos-pageses se kontributit te rene dakord ne afatin dhe shumen e caktuar si pershembull perjashtimin nga e drejta e votes dhe/ose zvogelimin proporcional te pjeses se ortakut ne Shoqerise dhe zvogelimin e kapitalit me masen e kontributut te papaguar.
- 7.4 Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet edhe permes nenshkrimit dhe shlyerjes se kuotes/ave te reja te kapitalit nga ortake te rinj. Ortaket e rinj do te duhet te pranohen



dhe te miratohen si te tille me nje vendim te Asamblese se Ortakeve me shumice te kualifikuar.

- 7.5 Vendimi per rritjen e kapitalit te Shoqerise me kontribute ne natyre, miratohet me shumice te kualifikuar. Ortaket i vleresojne kontributet ne natyre ne marreveshje te ndersjella me njeri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre ne para. Nese nuk mund te arrihet nje marreveshje, secili prej Ortakeve mund t'i drejtohet gjykates perkatese, per te ngarkuar nje ekspert vleresues, me nje vendim me efekt detyrues. Raporti i Ortakeve ose i Ekspertit per vleresimin e kontributeve i dorezohet Qendres Kombetare te Biznesit, se bashku me te dhenat e tjera te kerkuara per regjistrim.
- 7.6 Gjithashtu, kapitali i Shoqerise mund te zvogelohet me Vendimin e Asamblese se Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, sa here gjykohet e arsyeshme dhe ne cdo forme te mundshme te kontributit, pavaresisht llojit te kontributit te investuar, por asnjehere nen kufijte e parashikuara nga Ligji.
- 7.7 Asambleja e Ortakeve mund te miratoje me shumice te thjeshte financimin e Shoqerise nga Ortaket, si hua me interes ose pa interes, apo ne cdo forme tjeter te lejuar nga ligji qe eshte e ndryshme nga zmadhimi i kapitalit.

Neni 8

Certifikata e Kuotave te Kapitalit

- 8.1 Shoqeria mund te leshoje nje certifikate per te vertetuar zoterimin e kuotes se kapitalit. Kjo certifikate leshohet ne emer te personit apo personave qe zoterojne kuoten dhe nuk perben leter me vlere.


KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga Ortaket e saj.
- 9.2 E drejta e votes per secilin Ortak eshte ne perpjestim me vleren nominale te kuotes se tij, e barazvlefshme me perqindjen e pjesemarrjes se secilit Ortak ne kapitalin e regjistruar te Shoqerise, konkretisht:
- **Shoqeria TAG Engineering shpk**, , e cila zoteron 66.663% te kapitalit te regjistruar te shoqerise,
 - **Z.Bledar Dhima**, shtetas shqiptar, i cili zoteron 33,337% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.
- 9.3 Cdo kuote garanton te drejten e nje vote ne asamblene e pergjithshme te ortakeve ("**Asambleja e Ortakeve**"), te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese , te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimit te Shoqerise si dhe te drejtat e siguruar nga ky Statut, marreveshjet midis ortakeve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 9.4 Ortaket mund te rendojne me barre siguruese apo peng tjeter kuotat e tyre, vetem nese Asambleja e Ortakeve e miraton paraprakisht me shumice te kualifikuar.
- 9.5 Ne perputhje me Ligjin, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve merr vendime:
- a. Me shumice te thjeshte.



b. Me shumice te kualifikuar

c. Me unanimitet

- 9.6 Per vendimet qe kerkojne **shumice te thjeshte**, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kapitalit te Shoqerise dhe vendimet merren me 50%+1 te votave te Ortakeve pjesemarrjes, me te drejte vote.
- 9.7 Per vendimet qe kerkojne **shumice te kualifikuar**, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket te cilet se bashku zoterojne me shume se 50% te kapitalit te Shoqerise dhe vendimet merren me 75%+1 te votave te Ortakeve pjesemarrjes, me te drejte vote.
- 9.8 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos me shumice te kualifikuar:
- ndryshimin e statutit,
 - zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
 - riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise
 - shperndarjen e fitimeve ne raport me pjesemarrjen e cdo Ortaku ne kapitalin e Shoqerise;
 - cdo vendim tjeter te parashikuar shprehimisht ne kete statut.
- 9.9 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos me unanimitet per shperndarjen e fitimit sipas Nenit 17.3 te ketij Statuti.

Neni 10

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

10.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- Ndryshimet e Statutit;
- Emerimin e shkarkimin e Administratorit te Pergjithshem;
- Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- Percaktimin e shperblimeve per Administratorin, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- Shperndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- Ngritjen e padise perpara gjykates kompetente per shfuqizimin ne gjykate te vendimeve te Administratorit te Pergjithshem, kur keto perbejne shkelje te rende te Ligjit ose Statutit;
- Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit te Pergjithshem;

- Marrje ose dhenie huaje ne emer te Shoqerise, me institucionet bankare;
- Vendosjen e pengut e barreve hipotekore mbi pasurite e Shoqerise;
- Miratimin e Autorizimit te Posaçem per shfuqizimin e ndalimit te permendur ne piken 1 e 2 te Nenit 17 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", per konfliktin e interesit.

10.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ushtron çdo te drejte tjeter te parashikuar nga Ligji si kompetence e saj.

Neni 11

Menyra e thirrjes dhe votimit te mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme

- 11.1 Administratori duhet te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rastet e parashikuara nga Ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligje te tjera, sa here ta kerkojne Ortaket ne perputhje me Nenin 84 te Ligjit, dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise.
- 11.2 Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te votave te pergjithshme te Shoqerise mund t'i kerkojne administratorit me shkrim, perfshire posten elektronike, thirrjen e asamblese se ortakeve. Kerkesa duhet te mbaje arsyet dhe objektivat dhe çeshtjet per te cilat asambleja e ortakeve duhet te vendose. Administratori eshte i detyruar te mbledhe Asamblene e Ortakeve ne perputhje me nenin 84 te Ligjit per Shoqerite Tregtare, perndryshe ortaket qe kane kerkuar mbledhjen kane te drejte ta mbledhin vete Asamblene e Ortakeve sipas kerkeseve per njoftim te parashikuara ne nenin 11.3 me poshte. Nese ne kundërshtim me kete dispozite, Asambleja e Ortakeve nuk mblidhet, te gjithë ortaket qe kane derguar kerkesen per mbledhjen e Asamblese kane te drejtat e parashikuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare.
- 11.3 Asambleja e Ortakeve do te thirret me njoftim me shkrim te leshuar nga Administratori, i cili duhet t'u dergohet ortakeve apo perfaqesuesve te ortakeve jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dites se caktuar per asamblene. Njoftimi per ortaket duhet te percaktojte daten, oren dhe vendin e mbledhjes se asamblese si dhe çeshtjet per t'u diskutuar (rendi i dites) dhe, ne rast te nje asambleje te zakonshme te ortakeve, duhet te perfshije pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 11.4 Ortaket kane pergjegjesi personale per te njoftuar Administratorin e Shoqerise mbi te gjithë detajet e kontakteve te tyre, duke perfshire por jo duke u kufizuar ne adresen postare, adresen e postes elektronike, dhe gjithashtu per te njoftuar Administratorin mbi ndonje ndryshim te mepasshem te ketyre detajeve te kontaktit. Nese Ortaket nuk njoftojne ndryshimet ne kontaktet e tyre, njoftimi i kryer ne adresen e fundit te komunikuar tek Administratori Shoqerise do te konsiderohet i rregullt.
- 11.5 Per shmangien e çdo dyshimi, çdo njoftim apo komunikim tjeter i nevojshem per t'u bere sipas ketij Statuti, duhet te jete me shkrim, ne gjuhen shqipe, dhe duhet te dergohet dhe/ose merret ne nje menyra te meposhtme:
- Dergim dorazi; ose
 - Me e-mail;
 - Me poste rekomande.
- 11.6 Adresa e Administratorit do te konsiderohet adresa e selise se Shoqerise, por Administratori eshte megjithate i detyruar te siguroje te dhenat e kontakteve te tij/te saj personale (dhe çdo ndryshim tjeter te mepasshem) tek te gjithë Ortaket.



- 11.7 Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive Tregtare. Cdo ortak mund te shoqerohet ne mbledhjen e Asamblese nga jo me shume se dy keshilltare te tij te jashtem me cilesine e avokatit apo ekspertit ekonomik (nese keta ta fundit provojne kualifikimet perkatese), vetem nese paraprakisht Asambleja ka miratuar pjesmarrjen e tyre me kuorumin e pranishem dhe me shumice te thjeshte.
- 11.8 Nese Asambleja e Ortakeve eshte e mbledhur ne menyre korrekte, por numri i kerkuar i ortakeve per te plotesuar kuorumin nuk eshte prezent apo nuk eshte i perfaqesuar rregullisht, Asambleja e Ortakeve do te mblidhet serish ne perputhje me parashikimet e ketij neni por jo me vone se 30 dite. Rendi i dites i Asamblese se dyte nuk do te ndryshoje.
- 11.9 Kur Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk eshte thirrur sipas formaliteteve te pershkruara ne nenin 11 te ketij Statuti, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë Ortaket jane te pranishem dhe shprehen dakord per te marre vendime te vlefshme, pavaresisht parregullsise.
- 11.10 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve cakton nje Kryetar cili mund te jete njeri nga Ortaket.
- 11.11 Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato çeshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht, nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme.
- 11.12 Ortaket njohin dhe pranojne te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme qarkulluese me shkrim me kusht qe te ndiqen te gjitha procedurat e percaktuara nga ky Statut, duke pranuar me shkrim draftin e hartuar dhe te propozuar nga Administratori ose nga secili prej Ortakeve, pervec rastit kur kjo procedure refuzohet me shkrim (edhe me ane te postes elektronike) qofte edhe nga njeri prej Ortakeve. Vendimet e propozuara, se bashku me dokumentet qe mbeshtesin vendimet do t'i dergohen Ortakeve ne adresat perkatese te e-mailit. Ortaket duhet te vendosin mbi vendimet e propozuara brenda 7 (shtate) diteve kalendarike nga data qe vendimi me shkrim i eshte derguar ortakeve, duke i kthyer nje kopje te nenshkruar te vendimit me shkrim Administratorit te Shoqerise dhe gjithashtu duke dergur me e-mail nje kopje elektronike te vendimit te nenshkruar. Ortakeve qe kane kundërshtuar do t'u jepet mundesia te shprehin kundërshtimin e tyre ne lidhje me vendimin me shkrim ne dokumentin qe permban tekstin e vendimit te propozuar. Vendimi me shkrim do te konsiderohet i miratuar ne qofte se miratohet nga shumica e kerkuar ne Statut.
- 11.13 Ortaket mund te marrin vendime me shkrim ne mungese te formaliteteve te parashikuara me siper, vetem nese te gjithë ortaket pranojne te miratojne kete vendim.
- 11.14 Proçesverbalet e çdo Asambleje te Ortakeve do te mbahet ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare dhe nenshkruhen nga kryetari i Asamblese se Ortakeve, nga mbajtësi i procesverbalit dhe ortaket e pranishem. Kryetari i Asamblese se Ortakeve do te zgjidhet nga ortaket e pranishem ne Asamblene e Ortakeve, me shumice te thjeshte para se Asambleja te filloje te diskutoje rendin e dites, ndërsa mbajtësi i procesverbalit do te caktohet nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve. Asambleja e Ortakeve mund te vendose qe procesverbali te mbahet nga nje noter publik ne te cilin rast nuk eshte e nevojshme caktimi i mbajtësit te procesverbalit. Proçesverbali do te nenshkruhet nga Kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit/noteri publik dhe te gjithë ortaket e pranishem. Ne rast se



ndonjeri prej ortakeve te pranishem refuzon te nenshkruaje procesverbalin, ky fakt do te shenohet ne procesverbal. Esktraktet e procesverbalit te Asamblese se Ortakeve per qellim depozitimi ne Qendren Kombetare te Biznesit te cilat pasqyrojne vetem rendin e dites dhe vendimet e votuara ne Asamblene e Ortakeve, jane te vlefshme nese nenshkruhen nga te gjithë ortaket pjesemarrës ne Asamblene e Ortakeve duke paqyruar votat pro dhe kunder vendimeve te propozuara.

- 11.15 Asambleja e Ortakeve mund te miratoje me shumice te kualifikuar nje rregullore te vecante per procedurat e mbledhjes.

Neni 12

Votat e Ortakeve

- 12.1 E drejta e votes per secilin Ortak eshte ne perputhje me vleren nominale te kuotes se vet.
- 12.2 Ortaket njohin dhe pranojne se e drejta e votes mund te ushtrohet ne menytrat e parashikuara me poshte:
- Ushtrimi i se drejtes se votes per marrjen e vendimeve ne mbledhjet fizike te Asamblese se Pergjithshme.
 - Ushtrimi i se drejtes se votes per marrjen e vendimeve ne forme qarkulluese, ne perputhje me percaktimet e nenit 11.12 te Statutit.
- 12.3 Asnje Ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.
- 12.4 Çdo kundërshtim ne kohe per cilesine e nje votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

Neni 13

Administratori/et

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve emerone nje ose me shume persona fizik si Administrator te Pergjithshem te Shoqerise, sipas Nenit 81, paragrafi 1, pika c) dhe Nenit 95 te Ligjit.
- 13.2 Administrator i Pergjithshem i shoqerise iNext shpk, emerohet Znj. Bukuriye Malasi, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me nje afat prej 5 vitesh, duke nisur efektet nga data e nenshkrimit te ketij Statuti.
- 13.3 Shoqeria do te drejtohet nga Administratori/et, sipas afatit te percaktuar me vendim nga Asambleja e Pergjithshme.
- 13.4 Nese emerohen shume se nje administratore, ata do ta perfaqesojne Shoqerine bashkarisht, pervecse kur sipas vendimeve te Asamblese se Pergjithshme te miratuara here pas here, Administratoreve do t'u sigurohet e drejta per te perfaqesuar Shoqerine ne grupe prej dy personash dhe/ose individualisht per disa kategori veprimesh, me kufizimet perkatese ne lidhje me keto veprime. Keto vendime do te jene te detyrueshme per Administratoret dhe do te depozitohen ne Qendren Kombetare te Biznesit qe t'i behen te ditura edhe paleve te treta.



Neni 14

Kompetencat e Administratorit te Pergjithshem

- 14.1 Administratori i Pergjithshem detyrohet para Shoqerise te respektoj kufizimet e percaktuara me Ligj dhe nga Statuti, lidhur me hapesiren e autoritetit te tij menaxhues.
- 14.2 Kompetencat e Administratorit te Pergjithshem jane:
- a) Kryen veprimet duke respektuar kufizimet e vendosura ne Ligj dhe Statut, ne zbatim te politikave tregtare dhe detyrave te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
 - b) Perfaqeson shoqerine tregtare;
 - c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
 - d) Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim;
 - e) Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;
 - f) Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, siq parashikohet ne Ligjin per QKB;
 - g) Raporton perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare, detyrave dhe realizimin e veprimeve te posaqme, me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- 14.3 Te drejtat e perfaqesimit te Administratorit kundrejt te treteve mund te kufizohen me kerkesa te tilla si nje nenshkrim i dyte per veprime te caktuara te miratuara kohe pas kohe nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me shumice te thjeshte. Keto vendime do te jene te detyrueshme per Administratoret dhe do te depozitohen ne Qendren Kombetare te Biznesit qe t'i behen te ditura edhe paleve te treta.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit te Pergjithshem

- 15.1 Administratori i Pergjithshem eshte pergjegjes individualisht ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.
- 15.2 Ne rastin kur Administratori nuk respekton kufijte e mandatit te tij, cdo vendim i marre ne kundershtim me Nenet 10 dhe 14 me siper konsiderohet nul me fuqi prapavepruese, dhe Administratori do te jete pergjegjes per cdo pasoje qe do te rezultojte nga keto vendime, duke perfshire dhe pa u kufizuar ne detyrimet per deme te shkaktuara Shoqerise, Ortakeve ose paleve te treta.
- 15.3 Administratori i Pergjithshem detyrohet:
- te kryejte detyrat e tij, te percaktuara ne Ligj ose ne Statut, ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
 - te ushtroje kompetencat qe i njihen ne Ligj ose ne Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
 - te vleresojte me pergjegjesi geshtjet, per te cilat merret vendim;
 - te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

15.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te shkarkoje Administratorin e Pergjithshem ne çdo kohe, me shumice te thjeshte.

Neni 16

Perfundimi i detyres se Administratorit

16.1 Detyrat e Administratorit te Pergjithshem perfundojne ne rast se:

- Perfundon kohezgjatja per te cilen eshte emeruar.
- Shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, me shumice te thjeshte, ne çdo kohe.
- Administratori jep doreheqjen.
- Rastet e tjera te percaktuara nga Ligji

KREU IV

DIVIDENDET DHE SHPERNDARJA PARAPRAKE E FITIMEVE

Neni 17

Dividendet

- 17.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Ne lidhje me fitimin e shoqerise Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te vendose destinimin e tij konform ligjit ne fuqi. Si rregull, shperndarja e fitimit behet ne raport me pjesemarrjen e cdo Ortaku ne kapitalin e Shoqerise
- 17.2 Ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose me unanimitetin e votave te te gjithë Ortakeve te Shoqerise, nese shperndarja e fitimit, plotesisht apo pjeserisht, do te behet ne raporte te ndryshme nga kuota qe ka cdo Ortak ne Shoqeri. Ortaket bien dakord te pranojne dhe te zbatojne ne cdo rast vendimet e Asamblese se Pergjithshme te miratuara per kete qellim.
- 17.3 Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja ne perputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme. Ne baze te Ligjit, Shoqeria ka te drejte te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:
- aktivet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
 - Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme, brenda 12 muajve te ardhshem.
- 17.4 Administratori i Pergjithshem leshon nje Certificate te Aftesise Pagueese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 17.3. Kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, Administratori nuk mund ta leshoje kete certificate.
- 17.5 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, pa u mbyllur viti financiar, mund te vendose shperndarjen paraprake te fitimit, i cili rezulton nga bilanci i nje periudhe te ndermjetme, me kusht qe te plotesohen kerkesat e pikes 17.3 te ketij neni dhe ne perputhje me Certificaten e Aftesise Pagueese, te leshuar nga Administratori i Pergjithshem, sipas pikes 17.4 te ketij neni.



KREU V
MODIFIKIMI I FORMES LIGJORE; PRISHJA E SHOQERISE

Neni 18
Modifikimi i Formes Ligjore

- 18.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 18.2 Shoqeria e re do te respektojte te gjitha kerkesat dhe procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 19
Prishja e Shoqerise

- 19.1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:
- me Vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
 - me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
 - ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;
 - ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise;
 - ne raste te tjera, te parashikuara ne Statut;
 - ne raste te tjera, te parashikuara me Ligj.
- 19.2 Administratori i Pergjithshem regjistron prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, ne perputhje me nenin 43 te "Ligjit per Regjistrimin e Biznesit".
- 19.3 Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata ne perputhje me nenin 45 te "Ligjit per Regjistrimin e Biznesit", ia dergon vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

KREU VI
TE NDRYSHME

Neni 20
Largimi i Ortakut

- 20.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga Ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 21
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 21.1 Palet bien dakord qe cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me vlefshmerine, interpretimin apo zbatimin e Statutit, te zgjidhet nepermjet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 22
Te tjera

22.1 Çdo çeshtje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Ky Statut mbyllet me njëzet e dy nënë dhe nënshkruhet nga Ortaket në 2 (dy) kopje origjinale, me vlerë të njëjtte ligjore.

ORTAKET E SHOQËRISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

iNext sh.p.k.

Bledar DHIMA



BLEDAR DHIMA

TAG ENGINEERING SHPK

EDLIRA SHARA
ADMINISTRATORE E PËRGJITHSHME

